



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:243464

Datë: 22.07.2024

Numri i dokumentit: 05961874

P.nr.311/21

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Divizioni penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri si gjyqtare e vetme gjykuese, me sekretaren juridike Indira Beqa, punëtore e kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të pandehurit L.L nga Ferizaj, i akuzuar për shkak të veprës penale Falsifikimi dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës PP/II.nr. 1176/21 të datës 04.11.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më dt. 17.07.2023, në prezencën e prokurorit të shtetit Sadat Topalli dhe të pandehurit, me mbrojtësin e tij me autorizim, av. A.S., mori dhe shpalli, ndërsa me dt. 19.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit L.L, me adresë banimi në Ferizaj, rr.”...” hy.kati ..., i lindur më ... nga i ati B... dhe e ëma H..., e gjinisë I..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal:

Konform nenit 362 par 1 pika 1.1 te KPP-së,

REFUZOHET AKUZA

Sepse me datë 27.04.2021 në Kaçanik, ndryshon dokumentin origjinal me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si original, në atë mënyrë që në veturën e markës "...", ngjyrë e kaltër me targa ka ndryshuar numrin e karrocerisë ..., duke rivendosur numrin ..., fakt ky i vërtetuar nga raporti i ekspertimit të Agjensisë së Kosovës për Forenzikë, me nr. AKF/2021-1447/2021-1343 të dt.01.06.2021.

Me këto veprime, i pandehuri do të kryente veprën penale, Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës, confor nenit 453 të KPP-së.

Konfor nenit 276 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet automjeti i markës "... " me nr. të shasisë, polica e sigurimit me nr.0005371751 dhe librezja e këtij automjeti me nr. ...

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr. 1176/2021 të datës 04.11.2021, e akuzoi te pandehurin L.L nga Ferizaj, për vepër penale, Falsifikimi dokumenteve nga neni 390 par.1 të KPRK-së, dhe ka propozuar qe i njejt i shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze, me dt.21.04.2022, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me të cilin rast, pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori i shtetit , i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Me aktvendimin e dt.06.10.2023, Gjykata refuzoi parashtresën e të pandehurit, të parashtruar përmes mbrojtësit të tij, av. A. S., me të cilën ka kundërshtuar provat dhe ka kërkuar hudhjen e aktakuzës, pasi që Gjykata vlerësoi se dyshimi I bazuar mirë se I pandehuri e ka kryer ose jo veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, është fakt i cili duhet të vërtetohet në shqyrtimin gjyqësor, pas prezantimit dhe adminstrimit të provave të paraqitura nga prokurori dhe i pandehuri me mbrojtësin e tij.

Më datë 29.05.2024, 04.07.2024 dhe 17.07.2024, gjykata caktoi dhe mbajti seanca të shqyrtimit gjyqësor gjatë se cilit, pas administrimit të provave personale dhe materiale, prokurori i shtetit Sadat Topalli, në fjalën përfundimtare, deklaroi se tërhiqet nga ndjekja penale, me arsyetim se nuk ka prova se i pandehuri është kryes i veprës penale.

Andaj gjykata konfor nenit 362 par. 1 par.1.1 të KPP-së, vendosi që të Refuzojë aktakuzën kunder të pandehurit L.L.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë konform nenit 453 te KPP-së.

Vendimi për konfiskimin e automjetit, dhe dokumenteve të përshkruara sin ë dispozitiv, u mor konform nenit 276 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 të KPRK-së, meqë automjeti në fjalë e ka të manipuluar-falsifikuar numrin e shasisë, prandaj edhe konsiderohet send jashtë qarkullimit juridik

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
P.nr.311/21 datë 17.07.2024

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.